


Barometri Rajonal i Sigurisë

*Forumi Hulumtues i Sigurisë:
Beograd-Prishtinë- Tiranë*



BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Dhjetor 2013



Kosovar Center for Security Studie

MBËSHTETUR NGA:
**Ministria e Mbretërisë së
Norvegjisë për Punë të
Jashtme**

AUTORËT E RAPORTIT:

Mentor Vrajolli
Florian Qehaja

EKIPI I BKS:

Mentor Vrajolli, Koordinator i
Programit

Fjolla Raifi, Koordinatore e
Hulumtimeve në Terren

Skender Perteshi, zëvendës/
Koordinator për Hulumtime në
Terren

Sofije Kryeziu, Mbikëqyrëse në
terren

Abit Hoxha, Sigurimi i Cilësisë

Petrit Tahiri, Menaxher i SPSS
për futjen e të dhënave

Donika Emini, Formatizimi i
raportit

Çfarë është Barometri Kosovar i Sigurisë?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program special hulumtues i themeluar nga QKSS në Tetor të vitit 2012. Qëllimi kryesor për themelimin e BKS është zhvillimi i programit me të gjitha kapacitetet e cili në kuadër të QKSS të mbledhë, menaxhojë dhe analizojë të dhëna kualitative të hulumtimit. Programi i BKS përmban metodologjinë e krijuar ne veçanti për këtë program. Gjithashtu, programi ka zhvilluar staf shumë profesional dhe tanimë edhe me përvojë për të zhvilluar anketa të sakta dhe të besueshme. Në këtë mënyrë, Barometri ka prodhuar anketë të rregullt që vlerëson trendët e perceptimit publik ndaj sektorit të sigurisë dhe drejtësisë në baza gjashtëmujore. Si rrjedhojë, BKS është bërë një mekanizëm i mirënjohur, që zbatohet dhe komunikohet nga institute vendore në Kosovë. QKSS nuk ka ndonjë kufizim politik për të komunikuar të gjeturat dhe të dhënat. Botimi i këtij Edicioni Special të BKS është zhvilluar ne kuadër të Projektit Trepalësh Rajonal "Forumi Huluntues për Siguri: Beograd-Prishtinë-Tiranë".

Kë kemi në shënjestër me këtë edicion special?

"**Barometri Kosovar i Sigurisë: Edicion Special**" shënjestron një spektër të gjerë të audiencës nga Kosova, Serbia dhe Shqipëria. Përkatësisht, ka në shënjestër grupin e audiencës që është e interesuar të përcjellë trendet e opinionit publik në Kosovë në fushën e sigurisë, drejtësisë dhe marrëdhënieve ndëretnike mes qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë. Barometri ka në shënjestër politikë-bërësit nga këto tri shtete; praninë e komunitetit ndërkombëtarë në Kosovë dhe selitë e tyre; organizatat vendore dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile; akademitë në shtetet përkatëse, rajon dhe botë, si dhe mediat.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky botim paraqet një interpretim të shkurtër narrativ të të dhënave kuantitative të mbledhura nga QKSS në edicionin special të zhvilluar nën përkujdesjen e Forumit Hulumtues për Siguri "Beograd-Prishtinë-Tiranë" gjatë periudhës prej 01-15 tetor 2013.¹ Kjo anketë synoi vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve të Kosovës ndaj Serbisë dhe Shqipërisë si dhe marrëdhëniet ndëretnike.² Duke qenë që perceptimi i qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve dhe shtetasve të Shqipërisë është në përgjithësi shumë pozitiv, ky studim fokusohet kryesisht në interpretimin e perceptimeve ndaj bashkëpunimit ndëretnike dhe institucional, si dhe marrëdhëniet qytetare mes Kosovës dhe Serbisë.

Siç tregojnë të gjeturat e anketës, marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë si dhe besimi reciprok mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës janë ende në një nivel shumë bazik. Shumica e qytetarëve të Kosovës kanë mosbesim dhe frikë të shumëfishtë ndaj Serbisë. Ata akoma e shohin Serbinë si kërcënim për sigurinë e tyre kombëtare dhe konsiderojnë strukturat e Serbisë (siç janë ushtria, policia, xhandarmëria dhe shërbimet e saj të inteligjencës) si jomiqësore dhe kërcënuese ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Por në anën tjetër, rezultatet kanë treguar edhe optimizëm kur kemi të bëjmë me të ardhmen afatgjate paqësore mes Kosovës dhe Serbisë. Rreth 75% e të anketuarve konsiderojnë që nuk do të ketë më konflikt në Kosovë apo në rajon. Gjithashtu një pjesë e madhe e shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë besojnë që të dy komunitetet mund të jetojnë në paqe pranë njëri tjetrit në një të ardhme të afërt. Për më tepër, shumica e qytetarëve po mbështesin në një mënyrë apo tjetrën dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE) ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Anketa ka matur perceptimet e opinionit publik lidhur me bashkëpunimin e mundshëm në fushën e sigurisë. Qytetarët e Kosovës janë në dijeni që patrullimi i përbashkët kufitar mes policisë së Kosovës dhe policisë së Serbisë do të kontribuonte për një siguri më të mire për të dyja vendet. Ata gjithashtu potencuan rëndësinë e pjesëmarrjes së vendeve përkatëse në aktivitetet e përbashkëta për trajnime dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme për njeri tjetrin në raste të rreziqeve të ndryshme natyrore dhe/apo të shkaktuara nga njeriu.

Raporti gjithashtu shpalos perceptimin e qytetarëve të Kosovës ndaj sigurisë së tyre por e parë nga këndvështrimi i komuniteteve shqiptare dhe serbe. Të dy komunitetet konsiderojnë mjedisin e tyre, përkatësisht shtëpitë/banesat, lagjet, fshatin/qytetin si vende të sigurta, ndërsa sigurinë e përgjithshme në Kosovë e konsiderojnë të jetë e ultë. Frika dominuese ka të bëjë me numrin e shtuar të aksidenteve dhe plaçkitjeve, përderisa një numër i konsiderueshëm i të anketuarve kanë deklaruar se janë të kënaqur me reagimin që u ka ofruar policia atyre apo miqve/familjarëve të tyre.

Anketa gjithashtu ofron të gjeturat për besimin e qytetarëve ndaj Serbisë dhe qytetarëve të saj

¹Projekti i përbashkët zbatohet nga Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë –QKSS (Prishtinë) dhe partnerët e saj Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë –QBPS (Beograd) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim - IDM (Tirana).

²QBSP ka zhvilluar anketën për Serbi. Këto të gjetura për Serbinë mund t'i gjeni në www.bezbednost.org IDM ka realizuar anketën për Shqipërinë dhe të gjeturat për Shqipëri mund t'i gjeni në www.idmalbania.org

(përfshirë serbët që jetojnë në Kosovë). Anketa tregon që përafërsisht gjysma e popullatës së Kosovës kurrë nuk ka udhëtuar ndonjëherë në Serbi. Ndërsa, ata të cilët kanë udhëtuar ndonjëherë në Serbi, ka qenë para konfliktit të vitit 1999. Njësoj, indekset tregojnë që kontaktet mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës janë relativisht të rralla. Të gjeturat më kritike kanë të bëjnë me çështjen e martesave të përziera ndër-etnike ku 90% e të anketuarve kanë deklaruar që nuk do të martoheshin dhe as nuk do të donin të shihnin se po ndodhin martesa mes shqiptarëve dhe serbëve, gjë që tregon një nivel të lartë të mosbesimit mes këtyre dy komuniteteve.

Metodologjia

Anketa është edicion special i realizuar ekskluzivisht si pjesë e projektit trepalësh rajonal "Forum Hulumtues për Siguri: Beogradi–Prishtina-Tirana". Projekti Forum Hulumtues për Siguri mbështetet nga Ministria e Mbretërisë së Norvegjisë për Punë të Jashtme dhe implementohet në partneritet të ngushtë mes Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë –QKSSS (Kosovë), Qendrës së Beogradit për Politika të Sigurisë – QBPS (Serbia) dhe Institutit për Demoraci dhe Ndërmjetësim IDM (Shqipëria). Në këtë mënyrë, edhe qëllimi i anketës është që të mbulohet ky trekëndësh ku të gjitha organizatat partnere kanë mbuluar rastin e tyre përkatës të studimit. QKSS ka zhvilluar anketën e saj përmes programit tashmë të themeluar të njohur si Barometri Kosovar i Sigurisë.

Ekipi i QKSS-së është përgjegjës për përpilimin e pyetësorit fillestar dhe metodologjisë, ndërsa partnerët kanë kontribuar në fazën e finalizimit të tij. Anketa synon që në mënyrë gjithëpërfshirëse të masë perceptimin e qytetarëve dhe bashkëpunimin potencial mes shqiptarëve dhe serbëve në përgjithësi, duke u fokusuar në veçanti në bashkëpunimin Kosovë-Serbi, Shqipëri-Serbi dhe Kosovë-Shqipëri. Ky edicion special është realizuar përmes intervistave të drejtpërdrejta me një numër të caktuar të përzgjedhur të amvisërive, duke mbuluar të gjitha pjesët e Kosovës. Pyetësi ka përmbajtur më shumë se 100 pyetje, ku vetëm dy nga pyetjet e pyetësorit kanë qenë pyetje të hapura. Mostrat, pilotimi, intervistat, menaxhimi dhe analizat janë zhvilluar nga ekipi i QKSS-së duke involvuar më shumë se 30 hulumtues në terren. Mostra e nxjerrë në nivel nacional përfaqëson popullatën mbi moshën 18 vjeç dhe përfshinë 1118 amvisëri. Duke pasur parasysh qëllimin e anketës për të matur perceptimet e opinionit publik jo vetëm mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe dallimet ekzistuese në opinion mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve në Serbi dhe shqiptarëve që jetojnë në Jug të Serbisë, QKSS (Kosovë) dhe QBPS (Serbi) vendosën që të dyfishojnë mostrën për pakicën etnike përkatëse. Prandaj ndarja në baza etnike e të anketuarve të përzgjedhur në mostër është: 83% shqiptarë, 12% serbë dhe 5% të tjerë.

Korniza e mostrës është e bazuar në kodin e zonës telefonike dhe përfshinë regjionin e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajit, Gjilanit, Pejës dhe Gjakovës. Kombinimi gjeografik është bazuar në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë për 2012. Faza e dytë involvon mostrat e kombinuara sipas zonave komunale me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të amvisërive. Faza e fundit ka pasuar metodën e mostrës së thjeshtë që përdorë 'metodën e ditëlindjes'. Mostra e thjeshtë siguron që secili person, banor në Kosovë, gëzon probabilitetin për të qenë i përzgjedhur për

intervistë.

Si mostër reprezentative, rezultati i anketës mund të projektohet në popullatën e Kosovës si imazh pasqyrues për trendet në qëndrime dhe perceptime në mesin e Kosovarëve të rritur në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3% me intervalin e besueshmërisë prej 95%.

Në aspektin strukturor, dokumenti ka pesë kapituj. *Kapitulli i parë* synon interpretimin e rezultateve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe ndikimin që ato kanë në nivelin e sigurisë kombëtare në Kosovë. *Kapitulli i dytë* mbulon perceptimet e qytetarëve ndaj dialogut të lehtësuar nga BE në mes të Kosovës dhe Serbisë. *Kapitulli i tretë* mbulon perceptimet e qytetarëve drejt perspektives së bashkëpunimit mes Kosovës dhe Serbisë në fushën e sigurisë. *Kapitulli i katërt* mbulon perceptimin e qytetarëve të Kosovës ndaj sigurisë sipas këndvështrimit të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Ndërsa *kapitulli i pestë* ofron rezultatet e dalta në lidhje me perceptimin publik mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë.

1. Perceptimi publik për marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe ndikimi i tyre në sigurinë kombëtare të Kosovës

Pavarësisht konsensusit i cili ekziston ndërmjet organeve të sigurisë në Kosovë se vendit nuk i kanoset ndonjë rrezik i drejtpërdrejtë ndaj sigurisë kombëtare, hulumtimi tregon se qytetarët e Kosovës ende kanë dyshimet e tyre. Në pyetjen "deri në çfarë mase e konsiderojnë ata të rrezikuar sigurinë kombëtare të Kosovës" më shumë se 64% e të anketuarve kanë shprehur një dozë të frikës ku 16% prej tyre konsiderojnë këtë rrezik si të një niveli të lartë.




Figura 1: Perceptimet e të anketuarve lidhur me kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës

Ky shqetësim vjen si rezultat i marrëdhënieve ekzistuese të brishta ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe një diskursi politik të tendosur si jashtë ashtu edhe brenda Kosovës. Në fakt grafikoni në vijim tregon se në krahasim më Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi (të cilat kryesisht konsiderohen si vende miqësore ndaj Kosovës), më shumë se 69% e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si vend armiqësor.




Figura 2: Perceptimi i të anketuarve ndaj kërcënimeve të sigurisë kombëtare të Kosovës që vijnë nga vendet fqinje

Në të njëjtën mënyrë, hulumtimi tregon se qytetarët kanë një perceptim negativ ndaj institucioneve/strukturave serbe të sigurisë siç janë ushtria e shtetit, strukturat policore, xhandarmeria dhe shërbimi i fshehtë i Serbisë. Xhandarmeria serbe udhëheq këtë listë për shkak të pranisë së saj në kufirin me Kosovë si dhe aktiviteteve të raportuara në fshatrat e banuara më shqiptarë.




Figura 3: Perceptimet e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve/strukturave kryesore të sigurisë së Serbisë

Në fakt, kur i krahasojmë këto rezultate me treguesit e njëjtë sa i përket institucioneve të sigurisë së Shqipërisë, shihet se shumica e qytetarëve të Kosovës kanë perceptime tërësisht të ndryshme ndaj këtyre institucioneve.




Figura 4: Perceptimet e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve kryesore shtetërore të sigurisë së Shqipërisë

Rezultati pozitiv shënoi ngritje atëherë kur qytetarët e Kosovës shprehen interesim për të parë zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet kosovarëve dhe serbëve. Më saktësisht, në pyetjen se a është e mundur që shqiptarët dhe serbet të jetojnë së bashku në mënyrë paqësore, shumica e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht ndërsa më pak së 20% e tyre kanë dhënë përgjigje negative ndaj kësaj pyetje. Gjithashtu, të anketuarit ishin pyetur se a besojnë që në 5 vitet e ardhshme nuk do të ketë ndonjë konflikt të armatosur, ku më shumë se 63% e të anketuarve kanë hedhur poshtë mundësinë e ndodhjes së ndonjë konflikti tjetër në rajon në të ardhmen e afërt ndërsa 26% prej tyre mendojnë të kundërtën.




Figura 5: Perceptimi i qytetareve të Kosovës lidhur me mundësinë që Shqiptarët dhe Serbet të jetojnë së bashku në mënyrë paqësore




Figura 6: Perceptimi lidhur me ndonjë konflikt të ri në BP gjatë 5 viteve të ardhshme

Hulumtimi gjithashtu ka vlerësuar gatishmërinë e qytetarëve të Kosovës për t'iu përgjigjur së bashku me entitetet përkatëse në rast të një konflikti të armatosur në rajon. Ishte interesante të shihet se 97% e të anketuarve që i takojnë komunitetit shqiptar të Kosovës kanë treguar një lloj gatishmërie për t'ju ofruar përkrahje bashkëkombësve Shqiptar jashtë Kosovës në krahasim me 62% të anketuarve Serbë nga Kosova. Megjithatë, është me rëndësi të ceket se përkrahja të cilën ata ishin të gatshëm ta ofrojnë ishte kryesisht humanitare. Pra, më shumë se 56% e Shqiptarëve të Kosovës, përkatësisht me shumë 32% e Serbëve të Kosovës ishin të hapur që të pranojnë refugjatë në rast të një konflikti të tillë. Të tjerët do të

ofronin ndihmë financiare apo ndonjë ndihmë tjetër jo financiare. Ndërkohë, vetëm 16% e të anketuarve Shqiptarë të Kosovës, përkatësisht 19% Serbë të Kosovës me gjasë do t'i bashkoheshin një konflikti të armatosur.




Figura 7: Perceptimi i komunitetit shqiptarë dhe serbë të Kosovës ndaj një konflikti potencial në rajon i cili do të përfshinte bashkëkombësit e tyre

Në fund, të anketuarit ishin pyetur gjithashtu se a mendojnë që prezencja ndërkombëtare ende është e nevojshme për ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë. Rreth 30% e të anketuarve ishin në favor të vazhimit të misionit të KFOR-it për një periudhë shtesë të papërcaktuar. Përafërsisht 52% shprehën mendimin se ky mision duhet të tërhiqet brenda disa viteve, ndërsa 13% ishin të mendimit që KFOR-i do të duhej të ishte larguar nga Kosova tanimë. Ndryshe, qytetarët ishin me skeptik rreth rolit të EULEX-it. Vetëm 10% ishin të mendimit që ky mision i BE-së duhet të vazhdoj mandatin ende për një periudhë të papërcaktuar, rreth 37% ishin të mendimit që ky mision duhet të tërhiqet brenda disa viteve ndërsa më shumë se 38% ishin të mendimit se EULEX-i do të duhej të kishte shkuar tanimë, të përcjellë nga vetëm 5% të cilët ishin të mendimit se EULEX-i do të duhej të tërhiqej vitin e ardhshëm. Përveç KFOR-it dhe EULEX-it, të anketuarit ishin në gjendje të japin mendimin e tyre edhe sa i përket misionit të OSBE-së në Kosovë. Megjithatë, të anketuarit kishin vështirësi në sqarimin e rolit të OSBE-së në Kosovë.




Figura 8: Perceptimi i qytetarëve të Kosovës për tërheqjen e mundshme të KFOR-it, EULEX-it dhe OSBE-së

2. Perceptimet e qytetarëve për dialogun Kosovë-Serbi

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE-ja është procesi kryesor politik që nënvizon progresin e të dyja vendeve. Ky hulumtim ka konstatuar se e rëndësishme më të madhe është nevoja për matjen e perceptimit të publikut për dialogun. Hulumtimi përmbante disa pyetje direkte dhe indirekte lidhur me dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE-ja.

Pyetja e parë lidhur me këtë çështje ishte direkte, duke i pyetur të anketuarit se kush përfiton më së shumti nga dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shumica (ose në përqindje, më shumë se 60%) e të anketuarve ishin në dijeni të një ndikimi pozitiv nga dialogu; 19% deklaruan se Kosova është ajo që përfiton më shumë nga ky proces; 25% mendojnë se të dyja palët përfitojnë njësoj, ndërsa pothuajse 10% e të anketuarve kanë theksuar se komuniteti i Serb në Kosovë është përfituesi kryesor. Nga ana tjetër, 34% e të anketuarve ishin qartazi skeptikë ndaj rezultateve të dialogut meqë ata besojnë se është Serbia ajo që përfiton më së shumti nga ky dialog.




Figura 9: Perceptimet rreth përfituesit kryesor nga dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit

Të anketuarit ishin pyetur nëse Kosova dhe Serbia duhet ta vazhdojnë dialogun, ku më shumë se 73% e të anketuarve ishin në favor të vazhdimit të dialogut, prej të cilëve më shumë se 55% i thanë Po dialogut, por vetëm nëse ai e rritë mundësinë për t'iu bashkuar BE-së. Ndërsa, vetëm rreth 20% thanë se dialogu duhet të vazhdojë pavarësisht rrethanave. Nga ana tjetër, 21% thanë se nuk do të duhej të kishte dialog në mes të dy palëve.




Figura 10: Perceptimi nëse dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë

Pyetja e fundit direkte lidhur me dialogun ishte rreth ndikimit të dialogut ndaj bashkëpunimit ndëretnik. Më shumë se 59% e të anketuarve janë përgjigjur se dialogu do të përmirësojë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, ndërsa 31% kanë dhënë mendim të kundërt.




Figura 11: Perceptimi i qytetarëve të Kosovës për ndikimin e dialogut në bashkëpunimin ndëretnik

3. Bashkëpunimi në fushën e sigurisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Si shkak i mosmarrëveshjeve politike aktuale, bashkëpunimi në sektorin e sigurisë ndërmjet dy vendeve pothuajse nuk ekziston. Ndërsa, siç edhe është përmendur në kapitujt e parë, perceptimet e qytetarëve për institucionet serbe të sigurisë janë shumë negative.

Hulumtimi tregon se shumica e qytetarëve janë të vetëdijshëm se Kosova nuk ka zhvilluar ndonjë bashkëpunim në fushën e sigurisë me Serbinë. Më saktësisht, siç edhe është nënvizuar në Figurën 12, përafërsisht 80% e të anketuarve mendojnë se bashkëpunimi bilateral me institucionet e sigurisë të Serbisë është shumë i kufizuar, prej të cilëve 29% kanë deklaruar se nuk ka fare bashkëpunim. Duke pasur parasysh se Serbia është një prej shteteve fqinje të Kosovës, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë të të dyja shteteve reflekton një shqetësim serioz për qytetarët e Kosovës. Kjo po ashtu mund të nënvizohet gjatë krahasimit të perceptimeve për bashkëpunimin me institucionet e sigurisë të Shqipërisë, që në kuptim pozitiv paraqesin një pasqyrë krejtësisht tjetër.

Një rezultat pozitiv e reflekton mbështetjen e publikut për aspektet praktike të bashkëpunimit në fushën e sigurisë, që do të thotë patrullimet e përbashkëta të policive kufitare. Më saktësisht, më shumë se 63% e qytetarëve




Figura 12: Perceptimet e qytetarëve për nivelin e bashkëpunimit institucional me institucionet përkatëse të sigurisë nga Serbia dhe Shqipëria.

80% e të anketuarve mendojnë se bashkëpunimi bilateral me institucionet e sigurisë të Serbisë është shumë i kufizuar, prej të cilëve 29% kanë deklaruar se nuk ka fare bashkëpunim. Duke pasur parasysh se Serbia është një prej shteteve




Figura 13: Perceptimet në lidhje me patrullimet e përbashkëta të vijës kufitare të Policisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë

të Kosovës besojnë se duhet të ketë patrulla të përbashkëta të policive kufitare të Kosovës dhe të Serbisë, krahasuar me 31% të qytetarëve që ishin kundër. Përveç kësaj, një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve po ashtu u pajtuan se kjo është në dobi të të dyjave institucioneve të sigurisë, asaj të Kosovës dhe të Serbisë, që të marrin pjesë në trajnime të përbashkëta, konferenca dhe samite.

Respondentët ishin paksa më hezitues për pranimin e asistencës humanitare nga Serbia, në rast të fatkeqësive natyrore dhe/apo fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu. Siç tregon Figura 14, përafërsisht 50% e qytetarëve të Kosovës ishin kundër mbështetjes që mund të vie nga Serbia. Mirëpo, rreth 45% e tyre ishin në favor të pranimit të një ndihme të tillë në rast të ndonjë fatkeqësie në Kosovë. Sidoqoftë, kur të bëhet krahasimi i pyetjes së njëjtë lidhur me Shqipërinë, shifrat dallojnë shumë. Përafërsisht, 96% e qytetarëve të Kosovës janë të hapur për të pranuar ndihmë në rast të ndonjë fatkeqësie që mund të ndodhë në Kosovë. Megjithatë, duke marrë parasysh kujtesën ende të freskët të qytetarëve të Kosovës nga periudha e luftës për strukturat e sigurisë së Serbisë, 45% paraqet një shifër inkurajuese.




Figura 14: Perceptimet për pjesëmarrjen në trajnime të përbashkëta

Siç tregon Figura 14, përafërsisht 50% e qytetarëve të Kosovës ishin kundër mbështetjes që mund të vie nga Serbia. Mirëpo, rreth 45% e tyre ishin




Figura 15: Perceptimet nëse qytetarët pajtohen për të pranuar ndihmë emergjente nga strukturat e sigurisë së Serbisë dhe atyre të Shqipërisë

4. Perceptimi publik për sigurinë në Kosovë

Hulumtimi ka treguar se qytetarët e Kosovës janë më pak të kënaqur kur bëhet fjalë për nivelin e sigurisë së përgjithshme në Kosovë, krahasuar me sigurinë e mjedisit të tërësishëm ku ata jetojnë. Kjo më së miri mund të shpjegohet nga fakti se vetëm 36% e të anketuarve janë përgjigjur se ndjehen “kryesisht të sigurt” (23.1%) ose “plotësisht të sigurt” (13.2%) në Kosovë, ndërsa pothuajse gjysma e të anketuarve – përkatësisht 42%, ishin të pavendosur, kurse 21% u përgjigjën se ata ndjehen “kryesisht jo të sigurt” ose “vërtetë jo të sigurt” (7.4%). Ky perceptim i ulët kur bëhet fjalë për ndjenjën e sigurisë në Kosovë ekziston tek të gjitha komunitetet.




Figura 16: Perceptimi publik për sigurinë në Kosovë

Nga ana tjetër, të anketuarit kanë shprehur pikëpamje mjaft pozitive kur bëhet fjalë për mjedisin që i rrethon. Rreth 68% e të anketuarve kanë deklaruar se ndjehen ‘kryesisht (30.1%) ose plotësisht (37.6%) të sigurt në qytetin/fshatin e tyre dhe përqindja është rritur deri në 75% kur bëhet fjalë për sigurinë në lagje ose shtëpi/apartament. Nga ana tjetër, vetëm 9% e të anketuarve janë përgjigjur se ndjehen relativisht jo të sigurt ose vërtetë jo të sigurt në fshatrat/qytetet e tyre dhe përqindja bie në 6.3% kur bëhet fjalë për sigurinë në lagje. Vlen të përmendet se me një marginë prej 3%, ky perceptim ekziston tek të tek të dyja minoritetet dhe komuniteti shumicë në Kosovë.




Figura 17: Niveli deri ku qytetarët e Kosovës ndjehen të sigurt

Ajo që duhet të theksohet është se 89% e të anketuarve e asociojnë ndjenjën e tyre të sigurisë me sjelljet pozitive kolektive të qytetarëve, ndërsa vetëm 4% e të anketuarve ia atribuojnë këtë aftësisë së institucioneve të shtetit për të përmbushur detyrën e tyre në mënyrë të duhur, që edhe e tregon solidaritetin dhe një ndjenjë të bashkësisë në mesin e qytetarëve. Vetëm 7% e të anketuarve janë përgjigjur se ndjehen të sigurt sepse ata janë në gjendje ta mbrojnë veten. Ndërsa, në pyetjen më specifike se në kënd do të mbështeteshin më së shumti për ofrimin e sigurisë për familjet e tyre, 43% e të anketuarve janë përgjigjur se mbështeten në veten e tyre, 37% mbështeten në Policinë e Kosovës dhe 7% tek fqinjët e tyre.




Figura 18: Perceptimi se çfarë i bën qytetarët që të ndjehen më së shumti të sigurt

Ndërkohë, kur bëhet fjalë për shqetësimet e komunitetit për sigurinë, 42% e të anketuarve potencojnë se aksidentet në trafik përbëjnë shqetësimin e tyre më të madh, pasuar nga plaçkitjet (32%), incidentet e dhunshme (10%), fatkeqësitë natyrore (8%), dhuna familjare (3%), përderisa vetëm 3% e të anketuarve mendojnë se incidentet ndër-etnike janë shqetësim për sigurinë e tyre.




Figura 19: Kërcënimet kryesore ndaj sigurisë

Të anketuarit po ashtu ishin pyetur nëse ata ose familjarët e tyre kanë qenë në rrezik, ku vetëm 14% e tyre janë përgjigjur me 'po'. Prej tyre, vetëm 24% ishin të kënaqur me ndihmën e ofruar nga policia, ndërsa 41% ndanin mendime pozitive, kurse 35% e të anketuarve ishin të pakënaqur me reagimin e policisë në këtë drejtim.

Ajo që është me rëndësi të përmendet është se në pyetjen e hapur ku të anketuarit ishin pyetur në mënyrë direkte se "Kujt do t'ia raportoni një krim të dhunshëm?", më shumë se 87% e të anketuarve janë përgjigjur se ata do

të raportonin në Policinë e Kosovës, 5% do të raportonin tek akterët

ndërkombëtarë dhe 5% të tjerë janë përgjigjur se nuk do të raportonin fare. Kjo e tregon vetëdijësimin e përgjithshëm të popullatës lidhur me raportimin e incidenteve të mundshme në Policinë e Kosovës.




Figura 20: Niveli i kënaqshmërisë me ndihmën e ofruar nga policia

5. Raporti me Serbinë dhe qytetarët e saj (nga këndvështrimi i qytetarëve të Kosovës)

Aspektet praktike të jetës siç është lëvizja e lirë përtej kufijve si e drejtë themelore e njeriut është interpretuar dhe perceptuar ndryshe nga të anketuarit. Në pyetjen 'Sa të sigurt do të ndiheshit të udhëtonit në Serbi me targa të Kosovës?' 61% e të anketuarve u përgjigjën që do të ndiheshin të pasigurt për ta ndërmarrë një veprim të tillë. Ndërsa, pjesa tjetër e të anketuarve (12%) u përgjigjën se do të ndiheshin të sigurt. Kur të merret parasysh përbërja etnike dhe mostrat e zgjedhura të hulumtimit të tillë me numrin e serbëve të intervistuar, mund të shohim që një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës mendojnë që udhëtimi në Serbi me targa të Kosovës nuk është i sigurtë përkundër marrëveshjeve të arritura në




Figura 21: Perceptimi për udhëtimin në Serbi me targa të Kosovës

nivelin politik. Kjo tregon që duhet të bëhet edhe shumë punë në krijimin e besimit ndërmjet komuniteteve për ta siguruar respektimin e duhur të të drejtave themelore të njeriut në të dy vendet. Ngjashëm me grafikun e sipërpërmendur por me rezultate krejtësisht të kundërta, vetëm 3% e të anketuarve përfshirë shqiptarët e Kosovës mendojnë që nuk është e sigurt që të udhëtosh në Shqipëri me targa të Kosovës. Besimi ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Shqipërisë është i qartë dhe prandaj ekziston një tendencë në rritje të lëvizjes së njerëzve përtej kufirit. Vlen të theksohet se nga kjo pyetje vetëm 5% e të anketuarve mendojnë që është 'plotësisht e sigurt' të udhëtosh në Shqipëri me targa të Kosovës.




Figura 22: Perceptimi për udhëtimin në Shqipëri me targa të Kosovës

Udhëtimi në Serbi është ende tabu për pjesën më të madhe të shqiptarëve të Kosovës dhe kjo pasqyrohet në përgjigjet e dhëna, ku 49.2% e të anketuarve në Kosovë nuk e kanë vizituar Serbinë asnjëherë ku tregon gatishmërinë e vogël për ta njohur njëri-tjetrin. Pjesa më e madhe e atyre që kanë udhëtuar në Serbi kanë deklaruar që kanë udhëtuar për t'i vizituar miqtë dhe të afërmit e tyre në Luginën e Preshevës. Përveç kësaj, ky grafik tregon po ashtu që nuk ka shumë bashkëpunim ndërkufitar në asnjë fushë. Ngjashëm si edhe më sipër, grafiku tregon që shumica e respondentëve nuk dëshirojnë ta zbulojnë kur e kanë vizituar Serbinë për herë të fundit dhe kjo mund të interpretohet si mungesë e besimit në përçimin e porosive të vërteta. Më shumë se 23% e popullsisë së Kosovës e kanë vizituar Serbinë dhjetë vjet më parë.




Figura 23: Tendencat lidhur me sa shpesh udhëtojnë qytetarët e Kosovës në Serbi




Figura 24: Përgjigjet në pyetjen kur e kanë vizituar të anketuarit Serbinë herën e fundit?

Ky diagram e sqaron hartën e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë në përgjithësi. Vlen të theksohet se 15.6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve kanë thënë që kanë marrëdhënie familjare në Serbi, prandaj edhe marrëdhëniet e tyre me anën tjetër të kufirit janë të natyrës familjare ndërsa 36.2% nuk kanë kurrfarë lidhje me vendin fqinjë, Serbinë. Ky diagram përmban po ashtu një përqindje të lartë të kategorisë 'pa përgjigje' e cila do të mund të sqarohet me faktin që njerëzit nuk parapëlqejnë ta zbulojnë natyrën e marrëdhënieve të tyre me Serbinë në publik meqë kjo në të ardhmen do të mund të ishte akt stigmatizues.




Figura 25: Marrëdhënia e qytetarëve të Kosovës me Serbinë

Pothuajse 26% e të gjithë të anketuarve kanë miq ose të afërm që jetojnë në Serbi, ku konsiderohet si një numër i lartë, por duhet pasur parasysh që në këtë numër po ashtu bën pjesë edhe mostra e pakicës serbe. Përveç kësaj, 72.7% e të anketuarve nuk kanë as të afërm/miq që gjenden në Serbi dhe kjo e bën udhëtimin në Serbi në grafikun e mëparshëm më pak të rëndësishëm. Vazhdimi i ndarjes ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve në Serbi po ashtu sqarohet në grafikun e mësipërm ku 64.2% e të anketuarve kur nuk kanë folur apo nuk janë takuar personalisht me ndonjë serb apo ndonjë person nga Serbia, ndërsa 34% e kanë bërë këtë.




Figura 26: Përqindja e të anketuarve që kanë deklaruar që kanë të afërm në Serbi




Figura 27: Rezultatet sa shpesh kanë ndër vepruar të anketuarit me ndonjë serb apo person nga Serbia

Po të ishte përgjigja pozitive, ishin renditur kategoritë në vijim por shumica e të anketuarve kishin më shumë përvojë me serbët që jetojnë në Kosovë se sa me ata që jetojnë në Serbi. Përveç kësaj 66% ngurronin t'i identifikonin kontaktet e tyre dhe prandaj ngjashëm me grafiket e mësipërme, ky grafik tregon marrëdhëniet tabu ndërmjet individëve nga komunitetet e ndryshme. Kjo po ashtu mund të interpretohet në formën e mosgatishmërisë për ta njohur njëri tjetrin si fillim për dialog të frytshëm dhe bashkëjetesë.




Figura 28: Përgjigjet në pyetjen "Nëse po kush ishte ai person?"

Në rastin e bashkëjetesës ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ky është një ilustrim interesant i gatishmërisë së këtyre dy komuniteteve për të jetuar pranë njëri tjetrit. 55% e të anketuarve thanë që nuk do t'iu pengonte që të jetonin afër një familjeje serbe që mund të interpretohet si tendencë pozitive, megjithatë numri i njerëzve që kundërshtojnë vendosmërisht të jetuarit pranë një familjeje serbe është 40%. Ngurrimi për të jetuar pranë një familjeje serbe ishte i pranishëm në zonat kur tradicionalisht jeton shumica absolute e shqiptarëve.




Figura 29: A do t'ju pengonte të jetonit afër një familjeje serbe?

Audiençës i janë parashtruar pyetje më personale siç është martesat ndëretnike dhe rezultatet tregojnë një ndarje të madhe ndërmjet komuniteteve. Gjasat për t'u martuar në komunitetin tjetër për serbët dhe romët janë të ngjashme ndërsa për shqiptarët janë pothuajse 58%. 95% e të anketuarve nuk do të martoreshin me serbë ose me romë ndërsa 40% nuk do të martoreshin me një shqiptar të Shqipërisë. Indikatorët e tillë tregojnë që shoqëria nuk është e ndarë në nivelin politik por goxha thellë në nivelin shoqëror dhe personal po ashtu.




Figura 30: Rezultatet lidhur me pyetjen nëse shqiptarët e Kosovës do të martoreshin ose do t'ua lejonin anëtarëve të familjeve të tyre të bënin një gjë të tillë me ndonjë pjesëtar të komuniteteve në vijim: serb, shqiptar (nga Shqipëria) ose rom

Rreth 75% e popullsisë së Kosovës i marrin informatat për Serbinë apo serbët nga televizioni dhe 7% përmes internetit që tregon qartë që këmbimi personal i informatave mbetet shumë i ulët, me 5% nga familja dhe miqtë dhe 10% nga kontaktet personale me serbët. Në përgjithësi, përvoja personale përputhet me grafiket e mëparshme ku pothuajse numrat e përafërt kishin përvojë të drejtpërdrejtë me serbët.




Figura 31: Prej nga i marrin qytetarët e Kosovës informatat për Serbinë

Nga të anketuarit u kërkuar po ashtu ta japin mendimin për respektimin e të drejtave të pakicës etnike shqiptare në Serbi dhe anasjelltas nëse të drejtat e pakicës serbe në Kosovë respektohen. Një numër i madh i kosovarëve besojnë që ka shkelje të të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në luginën e Preshevës (74%). Krahasimi ndërmjet të drejtave të pakicave në Kosovë dhe në Serbi ua mundëson shqiptarëve të Kosovës të kenë përshtypje negative për temën po ashtu marrja e informatave nga mediat e njëanshme nuk i kontribuon krijimit të diskursit të tillë. Si krahasim, 79% e kosovarëve besojnë që të drejtat e serbëve që jetojnë në Kosovë respektohen mirë ndërsa 18% e thonë të kundërtën. Duke e ditur përqindjen e serbëve në Kosovë, 18% duhet t'i përfshijë pakicat e tjera dhe shqiptarët e Kosovës që mendojnë se të drejtat e serbëve të Kosovës nuk janë duke u respektuar.




Figura 32: Perceptimi i qytetarëve të Kosovës në lidhje me respektimin e të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi, përkatësisht të komunitetit serb në Kosovë

Në pyetjet lidhur me indikacionet për shtimin apo përmirësimin e dialogut ndëretnik janë dhënë përgjigje të cilat kryesisht ia kanë atribuar indikatorët më të rëndësishëm për shtimi të sigurisë (51.4%), njohjes më të mirë të njëri tjetrit (50.2%) që është pasuar nga përmirësimi i gjendjes ekonomike (42.4%) dhe marrëveshjet politike (41.90%). Por interesante dhe unike është që 41.7% e të anketuarve mendojnë që për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik më të rëndësishmet janë kualifikuar të jenë aktivitetet sportive.




Figura 33: Perceptimi ndaj indikatorëve të mundshëm kush do të mund ta përmirësonte dialogun ndëretnik

Projekti ka për qëllim të nxisë debat të balancuar midis qendrave hulumtuese (think-tank), komunitetit akademik, politikës publike dhe medias, në mënyrë që të sigurojë zgjidhje alternative për sfidat e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

KUSH JEMI NE?

Ne jemi tre qendra hulumtuese (think-tank) të pavarura nga Beogradi (BCSP), Prishtina (QKSS) dhe Tirana (IDM), të specializuara në hulumtimin e çështjeve të sigurisë të cilat ndajmë një shqetësim të përbashkët për sigurinë njerëzore dhe demokratizimin, duke besuar se përfshirja e aktorëve kompetent të shoqërisë civile në politikën e sigurisë rezulton në qeverisje transparente, demokratike dhe efektive. Para kësaj iniciative, bashkëpunimi ynë filloi që në vitin 2009 si rrjedhojë e një rrjeti rajonal hulumtues të titulluar Vlerësimi i Reformës së Sektorit të Sigurisë dhe projektit tjetër lidhur me transformimin e rajonit nga një zonë konflikti në një komunitet të sigurisë. Përveç kësaj, që të tre organizatat kanë një përvojë të dëshmuar mbi trajtimin e temave të tilla siç janë: konfliktet territoriale dhe demarkacioni i kufirit, ndërtimi i mirëbesimit rajonal, si dhe ndërtimi i rrjetit në mes profesionistëve të sigurisë dhe të rinjve.

KË PËRFAQËSOJMË?

Në takimet e Forumit Hulumtues për Siguri ne përfaqësojmë vetëm pikëpamjet tona personale dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojmë qëndrimet e organizatës ne përgjithësi, qeverisë përkatëse, ose grupeve të tjera të interesit. Mbështetja e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë nuk ndikon në rezultatin e gjetjeve të kërkimit ose iniciativave avokuese.

ÇKA DËSHIROJMË TË ARRIJMË?

Me këtë projekt ne do të mundohemi të ngrisim nivelin e bashkëpunimit dypalësh dhe trepalësh në çështjet e sigurisë duke krijuar linja të mes të komuniteteve të sferës së sigurisë (Beograd-Prishtinë-Tiranë) dhe rritjen e transparencës në qeverisjen e sigurisë. Prandaj ky projekt do të mundësojë shkëmbimin e praktikave pozitive dhe negative mes tri organizatave bashkëpunuese, si dhe do të nxisë bashkëpunime me komunitetet e sigurisë kombëtare në vendet përkatëse.

CILAT JANË PROBLEMET QË DUAM T'I ADRESOJMË?

Duke u nisur nga përvoja profesionale e tre organizatave, mund të konstatojmë se në rajonin tonë ekziston dilema e sigurisë si rrjedhojë e mungesës së transparencës në qeverisjen e sigurisë, frikës dhe mosbesimit reciprok, mungesës së informacionit të besueshëm si dhe burimeve të paanshme për zhvillimet në sektorin e sigurisë. Ky fenomen, në një masë të madhe, është shkaktuar nga një komunikim i mangët mes Beogradit, Prishtinës dhe Tiranës, jo vetëm në nivelet institucionale por edhe brenda shoqërisë civile dhe universiteteve. Kjo ka rezultuar në mungesën e njohurive mbi sektorët ne përgjithësi (sidomos në atë të sigurisë) duke çuar në drejtim të ideve dhe mendimeve krejtësisht të gabuara. Niveli i pamjaftueshëm i transparencës pengon mbikëqyrjen kombëtare të sektorit të sigurisë (duke përfshirë edhe atë nga shoqëria civile), si dhe në ndërtimin e besimit të nevojshëm për bashkëpunimin rajonal në çështje të sigurisë. Çështjet aktuale mbizotëruese jo vetëm kontribuojnë në dilemën e sigurisë në rajon, por ato gjithashtu pengojnë demokratizimin dhe proceset reformuese të tre shoqërive, duke devijuar vëmendjen nga çështjet e brendshme (sociale, ekonomike dhe politike).

ÇFARË SYNOJMË TË BËJMË?

Caku final i këtij projekti do të arrihet përmes hulumtimit, rrjeteve dhe aktiviteteve avokuese si dhe përmes aktiviteteve të ndryshme të ndërtimit të kapaciteteve të organizatave pjesëmarrëse.

Hulumtim mbi temat kyçe me interes të përbashkët në lidhje me perceptimet e kërcënimit, vështirësitë në qeverisjen e sigurisë dhe llogaridhënies të shkaktuara nga mungesa e bashkëpunimit, si dhe burime të tjera relevante që kanë për qëllim rritjen e të kuptuarit të dinamikës politike dhe transformimin e sigurisë së 'tjetrit'. Secila organizatë pjesëmarrëse do të përgatit dy botime në vit, të cilat do të jenë në dispozicion në të dy gjuhët (shqip dhe serbisht). Produktet e hulumtimit do të jenë burime të besueshme dhe të bazuar mbi fakte, duke plotësuar boshllëkun në gjendjen aktuale të njohurive mbi këto çështje. Një numër i shumëllojshëm i metodave të shkencave sociale do të përdoret për të mbledhur dhe analizuar të dhënat. Gurthemeli i përpjekjeve për bashkëpunim dhe avokim do të jenë tre takimet e Forumit Hulumtues për Siguri, një në secilin kryeqytet të organizatave partnere. Forumi Hulumtues për Siguri do të organizohet me qëllim për të diskutuar rezultatet e hulumtimit me anëtarët e komuniteteve të sferës së sigurisë në secilin vend. Forumet do të organizohen sipas rregullave të 'Chatham House', duke siguruar hapësirë për diskutime të hapura midis profesionistëve të sigurisë, hartuesve të politikave dhe dijetarëve të cilët, përfundimisht, do të vendosin kushte për krijimin e bashkëpunimit dypalësh dhe trepalësh në sferën e sigurisë. Aktiviteti që do të organizohet në vitin e dytë është Shkolla Verore, e cila synon përfshirjen e të rinjve nga komuniteti i sigurisë nga të tre vendet partnere. Pjesëmarrësit do të trajnohen për çështje të ndryshme të sigurisë rajonale, që ndërlidhen me ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit, si dhe politikë-bërjes në sferën e sigurisë. Kjo do të mundësojë zhvillimin e rrjeteve midis vendim-marrësve të ardhshëm, studiuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile. Së fundi, tryezat në nivel kombëtar do të organizohen dy herë në vit në secilin nga vendet e organizatave partnere, duke sjellë së bashku anëtarët e komunitetit të sektorit të sigurisë kombëtare për t'i njoftuar me rezultatet e hulumtimit të fundit, si dhe për të diskutuar pikëpamjet në vendosjen e lidhjeve të ngushta në mes të hulumtimit dhe politikë-bërjes. Së fundi, ndërtimi i kapaciteteve të organizatave partnere do të përfshijë tre trajnime të përbashkëta në aftësitë hulumtuese përkatëse dhe shkëmbimin e hulumtuesve ndërmjet organizatave partnere (tre hulumtues në vit). Shkëmbimi i hulumtuesve do të mundësojë krijimin e një bashkëpunimi të ngushtë kolegial në mënyrë që një pjesë e hulumtimit të kryhet bashkarisht? si dhe të bëhet shkëmbimi i njohurive përkatëse.

Një kopje e këtij raporti dhe të informatave duhet adresuar në:

Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Rr. Sylejman Vokshi 13/3

10000 Prishtina, Kosovë

Email: info@qkss.org

Telefoni: +381 (0) 38 221 420

Faqja e internetit: www.qkss.org